



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr 6097/6 prot

Tiranë, më 24 / 10 / 2014

Lënda: Metodika e vlerësimit të shpërndarjes të rrezatimit elektromagnetik dhe përcaktimi i zonës kritike të antenave celulare të një Stacioni Bazë, në afërsi të të cilit ndodhen dhe stacionet bazë të operatorëve të tjerë.

Gjatë përgatitjes së ekspertizave mbi shpërndarjen e rrezatimit elektromagnetik përreth Stacioneve Bazë (SB) të një kompanie, shpesh ndodh që në zonën kritike të llogaritur për stacionin bazë të kompanisë, të mbivendosen edhe fushat e rrezatimit jojonizues të kompanive të tjera celulare, duke sjellë një **modifikim të zonës kritike** të stacionit bazë në studim.

Duke pasur parasysh se qëllimi kryesor i hartimit të raporteve të vlerësimit të shpërndarjes së fushave elektromagnetike dhe përcaktimit të zonës kritike, është **mbrojtja e publikut** nga rrezatimet jojonizuese, në zbatim të kuadrit ligjor, nga KMR-ja kërkohet që në raport të shprehet qartë, që zona kritike e modifikuar nga fushat rrezatuese të kompanive të tjera **të mos prekë zonat publike**. Pra, kërkohet që kufijtë hapësinorë të Zonës Kritike Rezultante të jenë në largësinë mbi 2.2 metra nga sipërfaqja e tarracës (Tokës) ku është instaluar masti/kulla mbajtëse e antenave, si dhe nga fasadat e ndërtesave të larta që ndodhen aty rrotull SB-së.

Në vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit përreth një stacioni bazë (SB), rezultatet jepen përgjithësisht duke u mbështetur në kapacitetet maksimale të instaluar që janë vetëm potenciale, por që thuajse asnjëherë nuk arrihen gjatë 24 orëve të funksionimit, qoftë në orët me trafik të lartë, qoftë në stacionet bazë me pozicione kyçe dhe me ngarkesë në rrjet.

Në vendin tonë janë të përcaktuara me ligj **fuqitë maksimale të pajisjeve të transmetimit**, të cilat kontrollohen nga autoriteti kompetent, që është **Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar (AKEP)**.

Në disa raste një SB i një kompanie është instaluar në një vendndodhje (psh. tarracë e një pallati, çati e një shtëpie shumëkatëshe etj), ku ndodhen edhe një ose disa operatorë të tjerë të rrezatimeve jojonizuese.

Vlerësimi i bërë nga kompania nëpërmjet ekspertit të autorizuar mbështetet vetëm në të dhënat specifike dhe të detajuara të SB-së të kompanisë (në fuqitë e gjeneruara, gjeometritë e antenave të SB-ve, karakteristikat teknike, etj), të SB-ve në studim.

Për stacionet bazë të **operatorëve të tjerë të afërt** (p.sh në të njëjtën tarracë, ose në tarraca fqinjë) është lehtësisht e dukshme struktura e instaluar, çka çon në një vlerësim të **largësisë dhe lartësisë** së instalimit të antenave të operatorëve të tjerë, si dhe në vlerësimin e **azimuteve të antenave** (me një gabim deri në 5^0).

Në të gjitha instalimet e kategorisë së mësipërme mastet e SB-ve të operatorëve të ndryshëm të pranishëm në një tarracë, janë të paktën aq larg njëri-tjetrit sa që sigurojnë që Zonat Kritike të tufave rrezatuese të celeve të kompanive të ndryshme **nuk janë plotësisht të mbivendosura e të qendëruara**.

Në këtë mënyrë mbivendosja e Zonave Kritike të dy operatorëve (ose dhe më shumë) është e pjesshme; çka të thotë se dimensionet e Zonës Kritike Rezultante nuk rriten ndjeshëm.

Për ilustrim po marim **rastin hipotetik të mbivendosjes së qendëruar** të dy tufave rrezatuese, të dy operatorëve, duke supozuar se të dy kanë fuqi maksimale transmetuese të njëjtë. Llogaritjet e **zonës kritike të modifikuar** tregojnë se dimensionin maksimal d_1 (në drejtimin qendror) ose dimensionin maksimal d_{2p} (në drejtimin qendër - poshtë) i tufës rezultante, do të ishte jo më shumë se 40% më i madh se dimensionin respektiv i secilës tufë.

Rikujtojmë se ky rast hipotetik asnjëherë nuk mund të paraqitet në praktikë (zonat kritike të dy operatoreve të dala nga një qendër...), sepse mastet dhe kullat e SB-ve të operatorëve të ndryshëm janë të paktën disa metra larg njëri-tjetrit (sipas drejtimit horizontal e vertikal). Pra në rastin “më të keq” (në aspektin e mbrojtjes të publikut) **zona kritike rezultante, për shkak të pranisë së disa operatorëve fqinjë, nuk do të “rriste” dimensionet e saj më shumë se 40%,** në krahasim me ato të **zonës kritike** të operatorit në shqyrtim për rastin e fuqisë maksimale. Këto vlerësime mbështeten në “Metodën e llogaritjes së përmasave të Zonës Kritike...” të miratuara nga KMR Nr. 822, datë 13.02.2013.

Pajisjet radiotransmetuese që funksionojnë në Republikën e Shqipërisë janë të shoqëruara me dokumentin e **njohjes së konformitetit** nga AKEP-i, për të cilët gjatë vlerësimeve merret në konsideratë fuqia maksimale e lejuar sipas planit të përdorimit të frekuencave, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr.2418, datë, 06.02.2014.

1. Maksimumi i lejuar i fuqisë së transmetuar

Teknologji	Spektri 900 MHz	Spektri 1800 MHz
Për GSM	62 dBm për bartëse	62 dBm për bartëse
Për UMTS	65 dBm për bartëse	62 dBm për bartëse
Për LTE	65 dBm për 5 MHz	62 dBm për 5 MHz
Për WiMAX	65 dBm për 5 MHz	62 dBm për 5 MHz

Ekspertët, në raportet e tyre duhet të vlerësojnë shumatoren e kontributeve të gjithë operatorëve në një zonë publike (tarracë e një pallati, çati e një shtëpie shumëkatëshe, godine përballë, etj), duke u nisur nga supozimi se operatorët e tjerë kanë në përdorim fuqinë maksimale që lejohet në licensën e lëshuar nga AKEP (shih tabelën më sipër) dhe rezultatet e llogaritjeve për zonat ku mund të ketë mbivendosje të fushave (zonat kritike), do të jenë të mbivlerësuara në krahasim me realitetin.

SEKRETARI
Rustem PACI

KRYETARI
Ilir BEQAJ